



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/353/02-17732

Dt.15.09.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së aplikuesit: **Banka Kombëtare Tregtare – BKT, dega në Gjakovë**, për dhënien e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e erëmbrojtësit në hyrje të objektit ekzistues të Postës së Kosovës, me etazhitet P+0, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 04.L-174, si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET; aplikuesit: Banka Kombëtare Tregtare – BKT, dega në Gjakovë, ndërtimi i erëmbrojtësit në hyrje të objektit ekzistues të Postës së Kosovës, sipas Projektit të prezentuar, të aprovuar nga DUMM, në ngastrat kadastrale ndërtimore me nr. 693/1, 693/2 dhe 693/3, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të “PTK” SH.A., në rrugën “Nëna Tereze”, të cilat kanë vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+0, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit $S=9.04\text{ m}^2$.

Përdhesa: (Sip,Bruto): $S=9.04\text{ m}^2$

II. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin geodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

I. Investitori është i obliguar që:

- Të të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Pa pëlqimin e hartuesit të projektit ideor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

II. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.



Arsyetim

Banka Kombëtare Tregtare – BKT, dega në Gjakovë, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/353/01-17732 të datës 02.08.2017 për dhënien e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e erëmbrojtësit në hyrje të objektit ekzistues të Postës së Kosovës, me etazhitet P+0, në ngastrat kadastrale ndërtimore me nr. 693/1, 693/2 dhe 693/3, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të “PTK” SH.A. në rrugën “Nëna Tereze”, siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përmasë 1:500 për:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 18.08.2017, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 02.08.2017 (fotokopje) në pronësi të PTK-SH.A., të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) me numër të lëndës 2900/17, të datës 08.06.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kontratën mbi qiranë, me nr.01-1825/17, dt.11.07.2017, e lidhur dhe ndërmjet “PTK”SH.A. dhe BKT-Gjakovë, e vulosur nga palët kontraktuese.
5. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430/03-359-g-2017, dt.14.09.2017.
6. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në BKT-, filiali Gjakovë me datë 14.09.2017.
7. Projektin për ndërtim, i vërtetuar nga DUMM Gjakovë.

Taksa administrative është paguar në vlerën prej 23.23 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktivendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspekcionit,
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenel Shabani, jur.dipl.

U. D. D r e j t o r i

Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.




K.K. GJAKOVË

Z.K. : Gj. Qytet

Ng. nr. 693-1, 693-2, 693-3.

PLAN SITUACIONI P=1:250



18.08.2017

GPS

Auto CAD 2004

Punoi : Xhelal F. Zhubi inxh. i dip.
i gjeod.

Vërtetoi: N.P.SH. " GELI" Gjakovë

Frrok Hajdaraj